

Pjesa A: Pjesa e përgjithshme

- I. Dispozita të përgjithshme
- II. Marrveshjet Siguruese
- III. Ngjarjet e Siguruara
- IV. Limitet e Dëmshpërblimit
- V. Kufizimet Teritoriale
- VI. Përjashtime të Përgjithshme
- VII. Pagesa e Primit
- VIII. Parashikimet dhe procedurat per kerkesat per demshperblim
- IX. Kushtet e Përgjithshme
- X. Periudha e demshperblimit (Periudha e polices)
- XI. Shtesë për ndotjet

Pjesa B: Kushtet e Veçanta

- I. Objekti i Sigurimit
- II. Shtesa dhe kufizime te veçanta te mbulimit
- III. Ne mbulimin ne sigurim perfshihet sa me poshte, vetem me mareveshje te vecante nese percaktohet ne formular
- IV. Përjashtimet
- V. Ndërmarrjet e përbashkëta

Pjesa A: Pjesa e përgjithshme

I. Dispozita të përgjithshme

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Sigurimit të Përgjegjesisë Publike, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit". SIGAL GROUP, këtu më poshtë do të quhet "Siguruesi". Personi fizik ose juridik, interesi i të cilit do të mbulohet në sigurim sipas Kushteve të Sigurimit të Përgjegjesisë Publike dhe të Produktit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "I Siguruari". Kontrata për Sigurimin e Përgjegjesisë Publike, lidhur midis Siguruesit dhe të Siguarit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit".

II. Marrveshjet Siguruese

Duke ju referuar kushteve, kufizimeve, përjashtimeve dhe konditave të tjera që përmban kjo policë dhe formulari, dhe me kusht që i Siguruari të ketë paguar ose të ketë rënë dakord për të paguar primin përkatës, i quajturi këtej e tutje "Siguruesi" bie dakord të dëmshpërblejë të Siguarin për:

1. Të gjitha shumat për të cilat i Siguruari do të bëhet ligjërisht përgjegjës të paguajë për kompensim, si dhe kostot e dëmeve dhe shpenzimet në lidhje me ndonjë ngjarje të siguruar, për të cilën kjo policë zbatohet, brenda limiteve të dëmshpërblimit të poshtëshënuara (deklarata), dhe në lidhje me biznesin, siç është përshkruar në formular, përfshirë njësinë e marrë me qira ose në pronësi të të Siguarit.
2. Të gjitha shpenzimet për mosmarrëveshjet, të kryera me miratimin paraprak me shkrim të Siguruesit, në lidhje me ndonjë kërkesë dëmshpërblimi ndaj të Siguarit, kërkesë për të cilën zbatohet dëmshpërblimi i shprehur në këtë policë.

III. Ngjarjet e Siguruara

Siguruesi ofron sigurimin e Përgjegjesisë Publike dhe detyrohet të dëmshpërblejë të Siguarin, për aq sa ai është civilisht përgjegjës me ligj:

1. Për Përgjegjësinë Publike:
 - a) Për dëmtime trupore (përfshirë vdekjen, sëmundjen ose plagosjen e/ose ndaj personave);
 - b) Për humbje ose dëmtime pasurore, të ndodhura gjatë Periudhës së Dëmshpërblimit, por përjashtuar përgjegjësia e produktit.

IV. Limitet e Dëmshpërblimit

Limitet e shënuara në policë përfaqësojnë maksimumin që Siguruesi është i detyruar të paguajë për çdo dëmtim, dhe në asnjë rast ai nuk do të përgjigjet për shuma më të mëdha.

a) Për çdo ngjarje

Përgjegjësia e Siguruesit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme për çdo pretendues ose një numër pretenduesish, për çdo ngjarje, nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si limiti i dëmshpërblimit për çdo ngjarje.

b) Klauzola e serisë së dëmeve

Për të përcaktuar kufirin e përgjegjësisë së Siguruesit në lidhje me ngjarjet e siguruara, ngjarjet e përcaktuara më poshtë do të konsiderohen si një ngjarje dhe se kanë ndodhur gjatë Periudhës së Dëmshpërblimit në të cilën ka ndodhur dëmi i parë.

c) Limiti agregat

Përgjegjësia e Siguruesit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme në lidhje me të gjitha ngjarjet e ndodhura gjatë çdo Periudhe Dëmshpërblimi nuk do të kalojë shumën e përcaktuar si limiti agregat përmbledhës.

V. Kufizimet Territoriale

- Kushtet e Përgjithshme janë të vlefshme brenda territorit të Republikës së Kosovës.
- Polica e Sigurimit i nënshtrohet ligjit dhe juridiksionit të Republikës së Kosovës.

VI. Përjashtime të përgjithshme

Kjo policë nuk do të zbatohet për:

1. Përgjegjësinë që i takon dëmtimeve trupore ose sëmundjeve të çdo personi, sipas një kontrate punësimi ose marrjeje në provë nga i Siguruari, nëse një përgjegjësi e tillë ka lidhje me dëmtimet trupore ose sëmundjet që rrjedhin prej ose gjatë periudhës së punësimit.
2. Përgjegjësinë në lidhje me:
 - a. Çdo mjet (ose rimorkio të bashkuar me të) të licencuar për përdorim në rrugë publike ose mjet për të cilin kërkohet sigurim i detyrueshëm sipas legjislacionit të trafikut rrugor, nëse ky mjet është në pronësi, është marrë me qira, ruhet ose drejtohet nga i Siguruari i përcaktuar në formular, ose nga personi që kërkon dëmshpërblim.
 - b. Nga përdorimi i mjeteve motorike, makinave ose pajisjeve të drejtuara ose të përdorura nga persona që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç.
 - c. Ngarkimi ose shkarkimi nga/ose në mjet ose rimorkio.
3. Përgjegjësinë në lidhje me:
 - a. Anije ose avion (përveç varkave me rrema) që janë prodhuar ose kanë si destinacion lundrimin ose udhëtimin në ujë, ajër ose hapësirë, nëse kjo anije ose avion është në pronësi të, është marrë me qira ose hua, ose trajtohet nga i Siguruari.
 - b. Ngarkimi ose shkarkimi nga/ose në çdo lloj anijeje, mjeti lundrues ose avioni.
4. Përgjegjësinë për ndonjë humbje financiare që nuk rezulton nga humbje pasurore ose dëmtime trupore, siç është përcaktuar në Seksionin II (humbje thjesht financiare).
5. Çdo shërbim, këshillë ose trajtim profesional të dhënë, administruar ose të neglizhuar nga i Siguruari (dëmshpërblim profesional).
6. Përgjegjësinë e çfarëdo lloj natyre që direkt ose indirekt shkaktohet nga, ndikohet ose rrjedh prej ndotjes së ajrit, ujit ose tokës.

7. Përgjegjësinë në lidhje me humbjen ose dëmtimin e pasurisë:
 - a. Që i përket të Siguruarit.
 - b. Që përpunohet nga/ose është nën kujdesin, ruajtjen apo kontrollin e të Siguruarit, ose të çdo personi të punësuar nga/ose që punon për të Siguruarin.
8. Përgjegjësinë për humbje ose dëmtime të pasurisë që rrjedhin nga zjarr, rrufe ose eksplozion në njësinë e të Siguruarit.
9. Kërkesat për dëmshpërblim në lidhje me vonesën në realizimin ose plotësimin e kontratave të lidhura.
10. Pretendimet për dëmtime të punimeve ose mallrave të prodhuara ose furnizuara nga i Siguruarit (nga palë të treta sipas porosisë apo për llogari të tij), për shkak të brendshme në fabrikim ose furnizim.
11. Përgjegjësinë në lidhje me kthimin, rivendosjen, riparimin, montimin ose koston e/ose zvogëlimin në vlerë të ndonjë malli ose mallrash të furnizuar, instaluar ose montuar nga i Siguruarit, nëse përgjegjësitë rrjedhin nga ndonjë defekt i brendshëm ose natyra e dëmshme ose e papërshtatshme e mallrave.
12. Përgjegjësinë në lidhje me ndonjë artikull ose mall të furnizuar, instaluar ose montuar nga i Siguruarit për qëllime të aviacionit, anijeve kozmike ose industrisë së automobilave (përfshirë ndonjë pjesë këmbimi ose përbërëse).
13. Përgjegjësinë në lidhje me ngjarje që janë rrjedhojë e një veprimi të pandershëm, të qëllimshëm ose të neglizhencës së të Siguruarit dhe që duhet të ishin parashikuar prej tij, duke pasur parasysh natyrën dhe rrethanat e këtij veprimi ose neglizhence.
14. Përgjegjësinë e marrë përsipër nga i Siguruarit sipas një kontrate ose ndonjë lloji tjetër marrëveshjeje, përveç rasteve kur këto përgjegjësi do t'i ishin ngarkuar të Siguruarit edhe në mungesë të kontratave ose marrëveshjeve të tilla.
15. Çdo përgjegjësi e çfarëdo natyre që direkt ose indirekt shkaktohet nga, kontribuohet nga ose rrjedh nga:
 - a. Rrezatimi ose ndotja jonizuese nga radioaktiviteti i karburanteve bërthamore, rrjedhjeve bërthamore ose djegies së karburanteve bërthamore.
 - b. Eksplozivë toksikë, radioaktivë ose lëndë të tjera të rrezikshme nga përbërje eksplozive bërthamore ose pjesë përbërëse të tyre.
 - c. Asbestoza ose sëmundje të tjera të lidhura me të (përfshirë kancerin), që rrjedhin nga ekzistenca, prodhimi, trajtimi, përpunimi, shitja, shpërndarja, magazinimi, depozitimi ose përdorimi i asbestit dhe/ose produkteve që përmbajnë asbest.
16. Përgjegjësinë për çdo pasojë të luftës, pushtimit, veprimeve të armiqve të jashtëm (në luftë ose jo), luftës civile, revolucionit, ndërhyrjes ushtarake, uzurpimit me forcë të territorit, vandalizmit ose sabotimit.
17. Gjobat dhe masat ndëshkuese.

VII. Paguesa e Primit

Pikenisja dhe periudha e Sigurimit

I Siguruarit është i detyruar të paguajë, tek Siguruesi ose tek qendra e agjensisë në të cilën është nënshkruar kontrata me skadencat përkatëse, të njëjtin prim të caktuar në kontratë. Vjelja e primeve në vazhdimësi realizohet në vendbanimin e të Siguruarit, ai nuk mundet të asnjë mënyrë të perjashtohet nga një detyrim i tillë.

Kesti i pare duhet te jete paguar me dhenien e kontrates. Kestet pasardhese paguhen me dhenien e deshmive te pagesave qe duhet te mbaje daten e pagimit dhe firmen e personit qe sigurohet. Sigurimi hyn ne fuqi ne oren 24 te dites se shenuar ne police, ne se ne kete moment primi eshte paguar, ne rast te kundert hyn ne fuqi ne oren 24 te dites se kryerjes se pageses. Primi mbetet i pezulluar ne ditën e skadences se caktuar ne kontrate.

Per primet pasuese se pari eshte lejuar kufiri per tu respektuar prej 15 diteve, gjate te cilave sigurimi mbetet pezull, dhe rihyn ne fuqi ne oren 24 te dites se pagimit te primit duke mbetur te pandryshuara skadencat e percaktuara ne kontrate.

Gjate 15 diteve te mesiperme, Siguruesi ka te drejten te deklaroje me leter rekomande, rizgjdhjen e kontrates, duke ndaluar te drejten e primeve te skaduara dhe te kerkoje ekzekutimin ligjesisht. Primi eshte gjithmone vendimtar per periudhen e sigurimit prej nje viti sepse zgjidh ceshtjet e kontrates.

Rregullimi i Primit

Primi, i caktuar në bazë të elementeve të rreziqeve të ndryshueshme, parapaguhet në mënyrë provizore në shumën që rrjedh nga llogaritjet në policë dhe rregullohet në fund të çdo periudhe sigurimi vjetore ose më të shkurtër të kontratës, sipas ndryshimeve të ndodhura gjatë të njëjtës periudhë, në elementet e marrë si bazë për llogaritjen e primit, duke mos ndryshuar primin minimal të përcaktuar në policë.

Për këtë qëllim, brenda 60 ditëve nga fundi i çdo periudhe vjetore të sigurimit ose të një kohëzgjatjeje më të shkurtër të kontratës, I Siguruari duhet të njoftojë me shkrim Siguruesit të dhënat e vijueshme, si: informacionin e elementeve të ndryshueshme të shënuar në policë.

Diferencat aktive dhe pasive, që rezultojnë nga rregullimi i primit, duhet të jenë paguar brenda 30 ditëve të mëpasshme nga komunikimi i Siguruesit.

Nëse I Siguruari nuk kryen në kohën e caktuar njoftimin e të dhënave të mësipërme ose pagimin e diferencës aktive të detyruar, Siguruesi mund të fiksojë një afat të mëtejshëm, jo më pak se 15 ditë, pas të cilit primi i parapaguar në mënyrë provizore për këstet pasardhëse konsiderohet për llogari ose si garanci për atë periudhë sigurimi vjetore, për të cilën nuk është aplikuar rregullimi ose pagimi i diferencës aktive.

Garancia mbetet e anuluar deri në orën 24 të ditës në të cilën I Siguruari ka përmbushur detyrimet e tij, pa prekur të drejtën e shoqërisë për të vepruar juridikisht ose për të deklaruar, me letër rekomande, zgjidhjen e kontratës.

Për kontratat e skaduara, nëse I Siguruari nuk plotëson detyrimet në lidhje me rregullimin e primit, Siguruesi, duke ndaluar të drejtën e saj për të vepruar ligjesisht, nuk është i detyruar për dëme të ndodhura në periudhën të cilës i referohet mungesa e rregullimit.

Sa herë që sipas një rregullimi vjetor, bilanci i elementeve të ndryshueshme të rrezikut tejkalon dyfishin e asaj që është marrë si bazë për përcaktimin...

XIII. Parashikimet dhe procedurat për kërkesat për dëmshpërblim

1. I Siguruari do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe për të lehtësuar dëmtimet trupore, sëmundjet, humbjet ose dëmtimet pasurore, të cilat mund të shkaktojnë lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj police.
2. Çdo ngjarje, e cila do të sillte lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas polices, duhet të raportohet me shkrim Siguruesit brenda 48 orëve.

Asnjë korrigjim ose riparim nuk do të bëhet përderisa Siguruesi të bëjë investigimin. I Siguruari duhet të japë njoftim të menjëhershëm për çdo ndjekje penale për plagosje fatale ose procedura civile në lidhje me ngjarjen, dhe do t'i dërgojë menjëherë Siguruesit të gjitha dokumentat që kanë të bëjnë me çështjen.

3. Asnjë pranimi i përgjegjësisë, premtim, ose pagesë nuk do të bëhet pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Siguruesi do të ketë të drejtën, sipas zgjedhjes së tij, të marrë përsipër dhe të drejtojë në emër të Siguararit mbrojtjen dhe rregullimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim dhe të procedojë me shpenzimet dhe në të mirën e tij çdo pretendim për dëmshpërblim ose dëme ndaj çdo personi tjetër, dhe I Siguruari duhet të japë gjithë informacionin dhe ndihmën e kërkuar.
4. Siguruesi mund t'i paguajë I Siguararit shumën maksimale të pagueshme sipas kësaj police në lidhje me çdo ngjarje ose çdo shumë më të vogël me të cilën mund të rregullohen pretendimet që lindin nga një ngjarje e tillë, dhe Siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi të mëvonshme në lidhje me atë ngjarje, me përjashtim të pagesës së kostos dhe shpenzimeve të mosmarrëveshjeve të shkaktuara për pagesa të tilla.
5. Nëse në kohën e ndonjë ngjarje ose pretendimi për dëmshpërblim ekziston një policë tjetër për dëmshpërblim ose sigurim në favor të/ose e ndikuar nga/ose në emër të Siguararit, e zbatueshme në të tilla ngjarje, Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës sipas kësaj police për të dëmshpërblyer I Siguararin në lidhje me këtë ngjarje ose pretendim, me përjashtim të pjesës që tejkalon shumën e cila do të ishte e pagueshme sipas dëmshpërblimit ose sigurimit tjetër sikur kjo policë të mos ishte në fuqi.

IX. Kushtet e Përgjithshme

1. Kjo policë, shtojcat e poshtëshënuara, formulari dhe kushtet specifike do të lexohen së bashku si një kontratë, dhe çdo fjalë ose shprehje për të cilën i është atribuar një kuptim i veçantë në çdo pjesë të kësaj police, formularit ose kushteve të veçanta, do të mbajë po atë kuptim kudo që shfaqet.
2. Nëse primi për këtë policë ka qenë kalkuluar sipas një vlerësimi të dhënë nga I Siguruari, ai do të mbajë shënime të sakta për gjithë detajet përkatëse dhe do të lejojë Siguruesin, në çdo moment të arsyeshëm të kohës, të inspektojë shënime të tilla. Me mbarimin e çdo periudhe dëmshpërblimi, do t'i dërgojë Siguruesit gjendjen e saktë të rregulluar, në mënyrë që për këtë periudhë të kalkulohet primi dhe diferenca e paguar nga I Siguruari si mbulim.
3. Siguruesi mundet në çdo kohë të arsyeshme të inspektojë çdo njësi dhe, në rast të ndonjë defekti ose rreziku të paraqitur, mund t'i japë njoftim me shkrim I Siguararit për rastet kur e gjithë përgjegjësia e Siguruesit, për arsye të defekteve dhe rreziqeve të tilla, do të pezullohet.
4. Nëse në një kohë të caktuar shfaqet materialisht diçka që ndikon në rrezikun e siguruar, I Siguruari duhet, brenda 7 ditëve, të japë njoftim me shkrim Siguruesit.
5. Vëzhgimi dhe plotësimi i detyrueshëm i kushteve, klauzolave e parashikimeve për sa i përket ndonjë gjëje që duhet kryer ose plotësuar nga I Siguruari, si dhe vërtetësia e pohimeve të bëra prej tij në kërkesën për sigurim (e cila duhet të jetë baza e kësaj kontrate), do të jenë kushte parësore për përgjegjësi të Siguruesit.

X. Periudha e dëmshpërblimit (Periudha e policës)

Periudha e dëmshpërblimit është 1 vit. Polica vazhdon të jetë e vlefshme dhe do të paguhet primi për periudhën vjetore pasuese, përveç rastit kur bëhet anulimi i kësaj policë me njoftim me shkrim nga njëra nga palët brenda 3 muajve nga çdo datë e përvjetorit.

XI. Shtesë për ndotjet

Kjo shtojcë modifikon perjashtimin VI.6 si me poshte:

Perjashtimi VI.6 nuk do të zbatohet për "plagosje trupore" ose "dëmtime pasurie" shkaktuar nga ngjarjet e menjehershme dhe aksidentale të mëposhtme:

- zjarri
- rrufeja
- eksplozioni

Pa kundërshtuar të përmendurat, është rënë dakord që mbulimi i siguruar nga kjo shtojcë nuk do të zbatohet për:

Humbjet, dëmtimet tek/ose humbje të përdorimit të pronës direkt ose indirekt rezultuar nga punimet nën tokë të Siguruarit dhe/ose zhvendosja e, humbje të/ose dëmtime të naftës nën tokë, gazit ose ndonjë substance tjetër.

Çdo truall i përdorur në tërësi ose pjesërisht për tregtim, trajtim, përpunim, ruajtje, sistemim, hedhje, të çdo materiali ose substance të padobishme.

Kostoja e vlerësimit dhe/ose vëzhgimit dhe/ose kontrollit të ndotjeve, dhe/ose substancave infektuese.

Kostoja e heqjes, dhe/ose asgjësimit, dhe/ose pastrimit të substancave rrjedhëse, ndotëse, infektuese të pasurisë të zotëruar dhe/ose dhënë me qira, dhe/ose nën kontrollin e Siguruarit.

Pjesa B: Kushtet e Veçanta

Veprimtarite që kanë lidhje me ndërtimin

I. Objekti i Sigurimit

1. Rreziku i Sigurueshem

Ky sigurim mbulon përgjegjësinë ligjore të të Siguruarit sipas policës së përgjegjësive publike dhe të produktit, por siç është përmendur nga kushtet e veçanta të mëposhtme:

- a. Si një kontraktues në veprimet e përshkruara në formular;
- b. Rrjedhur nga ushtrimi i aktiviteteve të përshkruara në formular;

2. Shtesë personash të Siguruar

- a. Përfaqësuesit ligjorë të të Siguruarit dhe personat të cilët ai ka punësuar për të drejtuar ose mbikëqyrur veprimet e siguruar ose ndonjë pjesë në cilësinë e tyre respektive si të tilla;
- b. Të gjithë punonjësit e tjerë të kompanisë për humbje të shkaktuara gjatë plotësimit të detyrave të tyre;

3. Sigurimi gjithashtu mbulon:

- a. Përgjegjësinë ligjore të të Siguruarit si pronar, marrëes me qira, përdorimit të pasurive (sidoqoftë me përjashtim të aeroporteve), ndërtesave ose njësive të përdorura ekskluzivisht për qëllimin e operacionit(t) të siguruarit ose si rezidenca të Siguruarit dhe punonjësve të shoqërisë së tij;
- b. Përgjegjësinë ligjore të personave përgjegjës në punë sipas kontratës për administrim, pastrim, ose mirëmbajtje të tjera të pronave për dëme të rrjedhura nga plotësimi i kërkesave të tyre.

II. Shtrirje dhe kufizime të veçanta të mbulimit

1. Kërkesa për dëshpërblim të jashtëm

- a. Sigurimi përfshin përgjegjësinë ligjore të Siguruarit rrjedhur nga:
- b. Humbje të ndodhura në vende të huaja (me përjashtim të SHBA-së dhe Kanadës), sic specifikohet më poshtë;
- c. Humbje në lidhje me udhëtimet e biznesit ose pjesëmarrjet në ekspozita dhe panaiere;
- d. Humbje të rrjedhura nga produkte të Siguruarit që kanë arritur në vende të huaja, të cilat nuk janë furnizuar direkt nga Siguruesi, ose që nuk janë transportuar direkt nga Siguruesi në këto vende.
- e. b) Përgjigjja e dëshpërblimit të Siguruarit është e pagueshme në monedhën vendase. Detyrimet e Siguruesit janë vlerësuar të plotësohen në një kohë të caktuar me një shumë prej _____ (në monedhën vendase), të derguar në një institucion të huaj financiar.
- f. c) Pretendimet për dëshpërblim të përgjegjësisë, për humbje që mund të jenë provuar se i atribuohen ngjarjeve të luftës ose veprimeve të tjera ushtarake, rebelimit, trazirave civile, grevave të përgjithshme, grevave ilegale ose të drejtuara nga ndonjë urdhër i ndonjë autoriteti publik, si edhe humbjeve të atribuara forcave të natyrës, janë përjashtuar nga mbulimi në sigurim.
- g. Nëse bën dakord dhe shënohet në formular, mbulimi përfshin përgjegjësinë ligjore të Siguruarit për humbje të ndodhura në vende të huaja në lidhje me:
 - Produktet që Siguruari ka furnizuar ose që janë shpërndarë atje;
 - Punën ndërtuese, riparuese, mirëmbajtjen (përfshirë shërbimin e shitësit dhe inspektimin).

2. Dëmet e lidhura me pronën e palëve të treta në të cilën është punuar

Duke u larguar nga Neni VI (7.2), përgjegjësia ligjore e rrjedhur nga humbjet e ndodhura në pronën e palëve të treta nga një aktivitet tregtar ose profesional i të Siguruarit që përfshin ose mbulon prona të tilla në kuadër të sigurimit.

Përjashtimet e Nenit VI (9) dhe Nenit VI (10) do të ruhen.

Pretendimet e ngritura nga ngarkimi ose shkarkimi nga/ose ndonjë mjet transporti tokësor ose detar, si edhe kontenieret dhe trailerët janë përjashtuar nga mbulimi në sigurim. I Siguruari do të përballojë një pjesë të zbritshme prej 20% (minimumi) për çdo kërkesë dëshpërblimi. Nën pjesa e zbritshme për çdo ngjarje është _____ (siç përcaktohet në formular). Kufiri agregat për të gjitha ngjarjet gjatë periudhës së policës së sigurimit është dyfishi i kësaj nene/pjesë.

3. Shpenzimet e retifikimit ose riparimit të punimeve defektoze ose defekteve në kryerjen e shërbimeve.

Ky sigurim mbulon dëmin pasuror që rrjedh si pasojë e punimeve defektoze ose defekteve në kryerjen e shërbimeve dhe mbulon gjithashtu shpenzimet e nevojshme (që kërkohen) për të mundësuar riparimin dhe kthimin në gjendjen e mëparshme të pasurisë defektore. Këto shpenzime nuk mbulohen nëse janë bërë për një riparim që nuk është bërë i nevojshëm drejtpërdrejt nga dëmi rrjedhës (vijues). Gjithashtu, nuk do të mbulohen në asnjë rast shpenzimet që bën i Siguruarit për riparimin vetë të pasurisë defektore.

4. Dëmtimi pasuror për shkak të forcave graduale ose rrjedhjes së ujit

Ky sigurim përfshin përgjegjësinë ligjore për kërkesat për dëshpërblim për dëmtime pasurore që rrjedhin nga:

- Efektet graduale të nxehtësisë ose të ftohtit, të gazrave, të avujve ose lagështisë, apo precipitimit (tym, blozë, pluhur etj.)
- Rrjedhja e ujit me përjashtim të dëmtimit në tubacionet drenazhuese që rrjedhin nga depozitimi i sedimenteve.

Neni VI (6) qëndron i pandryshuar.

5. Sedimentimi, dridhja, shkarja e tokës

Mbulimi në sigurim përfshin:

- Kërkesat për dëshpërblim të përgjithshëm për dëme pasurore për shkak të sedimentimit të njësisë së siguruar (gjithashtu një ndërtesë ose pjesë e një ndërtese e ngritur në njësi), dridhjet si rrjedhojë e goditjeve ose shkarjeve të tokës.

Sidoqoftë, kjo zbatohet vetëm atëherë kur dëmi peshon në njësi dhe/ose në ndërtesa ose pajisjet e vendosura aty.

III. Në mbulimin në sigurim përfshihet sa më poshtë, vetëm me marrëveshje të veçantë nëse përcaktohet në formular.

- Zotërimi ose drejtimi i mjeteve motorike për të cilat nuk kërkohet ligjërisht leje ose licencë për përdorim në rrugë, ose sigurimi i detyrueshëm.

Siguruesi çlirohet nga detyrimi për dëshpërblim nëse drejtuesi i një mjeti motorik nuk ka lejen/licencën e drejtuesit të mjetit në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

Përjashtimi Neni VI (2) mbetet i pandryshuar.

IV. Përjashtimet

(që ndryshojnë nga ato të përmendura në policën e përgjegjësisë publike dhe të produktit)

Këto kushte të veçanta nuk do të zbatohen në:

1. Përgjegjësinë për humbjet e pësuar në mallrat me komision.
2. Përgjegjësitë për humbjet që janë pasojë e moszbatimit të rregullave të përdorimit të materialeve të ndezshme ose shpërthyes.
3. Përgjegjësinë për humbjet e pësuar në lidhje me veprimtaritë minerare.

4. Përgjegjësitë për humbjet që rrjedhin nga veprimtari për të cilat nuk është përfunduar një mbulim në sigurim ose për ato që nuk përfshihen në mënyrë eksplicite (e paracaktuar) në këto kushte të veçanta, veçanërisht përgjegjësia që rrjedh nga:
 - a. Veprimtaritë, karakteristikat ose një marrëdhënie ligjore që as nuk është karakteristike për operacionet ose veprimtaritë e siguruara dhe as nuk është karakteristike e rrezikut të siguruar.
 - b. Furnizimi i energjisë elektrike, nxehtësisë, gazit dhe ujit.
 - c. Prodhimi, përpunimi, transporti, ruajtja e eksplozivëve për çdo qëllim.
 - d. Zotërimi ose operimi i hekurudhave, përveçse automjeteve me kabllo, hekurudhave me suspension ose vijave për transportimin e mallrave në një njësi operuese.
 - e. Ndryshimi i ambientit ujor.

V. Ndërmarrjet e përbashkëta

Për kërkesat për dëmsëpërblim të përgjithshëm që rrjedhin nga pjesëmarrja në një ndërmarrje të përbashkët, pavarësisht nga parashikimet e tjera të marrëveshjes (veçanërisht kufijtë e dëmsëpërblimit), do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

1. Detyrimi i siguroesit për dëmsëpërblim kufizohet në përqindjen e pjesës së të siguruarit në (ndërmarrjen) grupin e përbashkët pavarësisht se cilës shoqëri partner i përkasin personat ose pasuria (makina, pajisje ndërtimi, materiale ndërtimi etj.) që është përgjegjëse për humbjen.
2. Përrjashtohen nga mbulimi në sigurim:
Kërkesat për dëmsëpërblim të përgjegjësive që rrjedhin në lidhje me humbjet e pësuar nga çdo lloj pasurie e futur në ndërmarrjen e përbashkët nga partnerët individualë ose e blerë nga ndërmarrja e përbashkët, pavarësisht se cili është përgjegjës për humbjen.
3. Përrjashtohet gjithashtu nga mbulimi në sigurim:
Kërkesat për dëmsëpërblim që bëhen nga një partner i ndërmarrjes së përbashkët kundër një tjetri, si edhe kërkesat për dëmsëpërblim që bëhen nga ndërmarrja e përbashkët në cilësinë e saj si e tillë kundër çdo partneri ose anasjelltas.

Pjesa B: Kushtet e Veçanta

Shoqërit e ndërtimit

I. Objekti i Sigurimit

1. Rreziku i Siguruar

Ky sigurim mbulon përgjegjësinë ligjore të të siguarit sipas policës së përgjegjësisë publike dhe të produktit, por si ndryshohet nga këto kushte të veçanta si më poshtë:

Si kontraktues në operacionin(et) e përcaktuar në formular.

2. Shtesë personash të siguruar

a. Përfaqësuesit ligjorë të të siguarit dhe personat që ai ka punësuar për të drejtuar ose mbikëqyrur operacionin e siguruar ose çdo pjesë të tij në cilësinë e tyre si të tilla.

b. Të gjithë personat e tjerë të shoqërisë për humbjet që kanë lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

3. Ky sigurim mbulon gjithashtu:

c. a) Përgjegjësinë ligjore të të siguarit si pronar, marrëues me qira, përdorimit të pasurive (sidoqoftë me përjashtim të aeroporteve), ndërtesave ose njësive të përdorura ekskluzivisht për qëllimin e operacionit(ve) të siguruara ose si rezidenca të të siguarve dhe punonjësve të shoqërisë së tij.

d. b) Përgjegjësinë ligjore të të siguarit si ndërtues (pronar/zvillues) i ndërtesave në ndërtim. (Ndërmarrje të reja, rinovime, riparime, prishje, gjurmime) në njësinë e siguruar deri në një vlerë maksimale të kontratës prej _____ për projekt ndërtimi me kusht që vlera kontraktuale e objektit në fjalë nuk e kalon këtë shumë.

e. Përgjegjësinë ligjore të personave përgjegjës nga kontrata e punës për administrimin, pastrimin, ndriçimin ose shërbime të tjera të pasurisë, për kërkesat për dëmsëpërblim që kanë lidhje me plotësimin e këtyre detyrave.

II. Shtesa dhe kufizime specifike të masës së mbulimit.

1. Kërkesa për dëmsëpërblime të jashtme

a. Sigurimi përfshin përgjegjësinë ligjore të të siguarit që rrjedh nga dëme të pësuar në vende të huaja (përjashtuar SHBA dhe Kanadën) siç specifikohet më poshtë:

- Humbje në lidhje me udhëtime biznesi ose pjesëmarrjen në ekspozita ose panaire;
- Humbje që rrjedhin nga prodhime të të siguarit që janë futur në vende të huaja por nuk janë furnizuar nga vetë i siguruari ose kur nuk ka qenë i siguruari ai që ka organizuar dërgimin në këto vende.

- b. Dëmsëpërblimi i siguruesit i pagueshëm në _____ (monedha vendase)
Detyrimet e siguruesit quhen të plotësuara në momentin që shuma prej _____ (monedha vendase) është dërguar në një institucion financiar të huaj.
- c. Përjashtohen nga mbulimi në sigurim,
Kërkesat për dëmsëpërblim të përgjegjësive për humbje që mund të provohen se i atribuohen ngjarjeve të luftës ose veprimeve të tjera keqdashëse, turbullirave civile, rebelimeve, grevave të përgjithshme, grevave ilegale ose humbje që janë rrjedhojë direkte e urdhrave ose masave të marra nga autoritetet publike, si edhe humbjet që i atribuohen forcave të natyrës.
- d. Nëse është rënë dakord dhe përcaktohet në formular, mbulimi përfshin përgjegjësinë ligjore të të siguarit për humbjet e ndodhura në vende të huaja në lidhje me:
- Produkte të furnizuara nga i siguruari ose dërguar atje;
 - Punime montimi, mirëmbajtje (përfshirë inspektimin dhe shërbimin ndaj klientit) dhe punime riparimi.

Përfshirja e përgjegjësive ligjore për njësitë e biznesit, p.sh.: vendet e prodhimit ose zyrat shpërndarëse, magazinat e vendosura në vende të huaja kërkojnë parashikim të veçantë.

2. Dëmtime të linjave n/tokësore dhe linjave elektrike të varura.

- a. Në këtë mbulim përfshihet përgjegjësia ligjore që rrjedh nga dëmtimet në linja nentokesore (kablo, kanale n/tokësore, linja ajrore, linja gazi), si edhe linjat elektrike të varura, përfshirë dëmtimin e pësuar si pasoje e kësaj.
- b. Vetë i siguruari përballon një pjesë të zbriteshme prej 20%, një minimum prej _____ dhe një maksimum prej _____, të çdo humbjeje.
Kjo pjesë e zbriteshme rritet në 25%, minimumi _____ dhe maksimumi _____, nëse i siguruari ose përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk ka marrë informacion ose nuk i kalon autoriteteve përgjegjëse për ndërtimin, rezultatet e një investigimi për pozicionin dhe drejtimin e linjave nentokesore.
- c. Nën/pjesa e zbriteshme për çdo ngjarje është _____ (si përcaktohet në formular).
Pjesa e zbriteshme agregate për të gjitha ngjarjet e një periudhe të policës së sigurimit është sa dyfishi i kësaj nën/pjesës.

3. Kërkesat për dëmsëpërblim që i përkasin pasurisë së palëve të treta mbi të cilat punohet.

Në këtë mbulim në sigurim, përfshihet, pavarësisht nga Neni VI (7.2), përgjegjësia ligjore që rrjedh nga humbjet që pëson pasuria e palëve të treta nga veprimtaritë tregtare ose profesionale e të siguarit që ka të bëjë me këtë pasuri.

Do të ruhen përjashtimet e Neneve VI (9) dhe VI (10).

Kërkesat për dëmsëpërblim që rrjedhin nga ngarkimi ose shkarkimi nga/ose i çdo mjeti tokësor apo ujqor, si dhe rimorkiot dhe kontenierët përjashtohen nga mbulimi në sigurim.

Përjashtohen gjithashtu nga mbulimi në sigurim,

kërkesat për dëmsëpërblim që rrjedhin nga dëmtimi i linjave nentokesore dhe linjave elektrike të varura.

I siguruari përballon një pjesë të zbriteshme prej 10% (minimum i çdo humbjeje).

Nën/pjesa e zbriteshme për çdo ngjarje është _____ (si përcaktohet në formular). Pjesa e zbriteshme agregate për të gjitha ngjarjet e një periudhe policë është sa dyfishi i kësaj nën/pjesë të zbriteshme.

4. Punime prishjeje dhe shpërthyes

- a. Përrjashtohet kërkesa për dëmsëpërblim të përgjegjësise që i atribuohet prishjes së strukturave si edhe punimeve shpërthyes, me kusht që të mos ketë qenë bërë një marrëveshje e veçantë me siguruesin për përfshirjen e saj.
- b. Edhe në rastet kur është rënë dakord për një marrëveshje të tillë, përrjashtohen dëmet e pasurisë që rrjedhin nga punimet e prishjes brenda një rrezeje që i korrespondon lartësisë së strukturës që prishet. Në rastin e punimeve shpërthyes përrjashtohen dëmtimet në ndërtesat brenda një rrezeje prej 150m. Përrjashtimi Neni VI (6) nuk do të ndryshojë. I siguruari përballon një pjesë të zbriteshme prej 20% (minimum) për çdo humbje.

5. Shoqëritë ndërtuese/inxhinjeri civil/ndërtim rrugësh/prishëse.

- a. Ky sigurim mbulon gjithashtu përgjegjësinë ligjore për dëmet pasurore që shkaktohen prej banimit në ndërtesa (gjithashtu një ndërtesë ose pjesë ndërtuese ngritur në njësi), dridhjet si pasoje e goditjeve ose shkarjeve të tokës.

Sidoqoftë, kjo zbatohet vetëm atëherë kur humbja shkaktohet në njësinë dhe/ose në ndërtesat apo pajisjet e vendosura atje me kusht që kjo të mos ndodhë në vete sheshin e ndërtimit.

- b. Sigurimi mbulon gjithashtu përgjegjësinë ligjore për dëmet që rrjedhin nga punime forcuese ose nënkalime.
- c. Sidoqoftë, në këtë mbulim në sigurim nuk përfshihet përgjegjësia për:
 - Dëmet pasurore në njësitë, ndërtesat, pjesë ndërtesash ose pajisje që duhen forcuar ose krijuar nënkalime;
 - Dëmet që i përkasin ndërtimeve të tuneleve, galereve ose metrove;
 - Veprimtaritë e skicimit dhe mbikëqyrjes, me kusht që punimet e ndërtimit të mos kryhen nga i siguruari.

III. Vetëm me marrëveshje të veçantë dhe nëse përcaktohet në formular, mbulimi në sigurim do të përfshihet sa më poshtë:

Zotërimi ose drejtimi i mjeteve motorike për të cilat nuk kërkohet ligjërisht leje ose licencë për përdorim në rrugë, ose sigurim i detyrueshëm.

Siguruesi çlirohet nga detyrimi për dëmsëpërblim nëse drejtuesi i një mjeti motorik nuk ka lejen/licencën e drejtuesit të mjetit në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

Përrjashtimi Neni VI (2) qendron i pandryshuar.

IV. Përrjashtimet

(që ndryshojnë nga ato të përmendura në policën e përgjegjësise publike dhe të produktit)
Këto kushte të veçanta nuk do të zbatohen në:

1. Përgjegjësinë për humbjet e pësuar në mallrat me komision.
2. Përgjegjësinë për humbjet që janë pasoje e moszbatimit të rregullave për përdorimin e materialeve të ndezshme ose shpërthyes.
3. Përgjegjësinë për humbjet e pësuar në lidhje me veprimtaritë minerare.
4. Përgjegjësinë për humbjet që rrjedhin nga veprimtari për të cilat nuk është përfunduar mbulimi në sigurim, ose për ato që nuk përrshihen në mënyrë eksplicite (e paracaktuar) në këto kushte të veçanta, veçanërisht përgjegjësia që rrjedh nga:

- a. Veprimtaritë, karakteristikat ose një marrëdhënie ligjore që as nuk është karakteristike për operacionet ose veprimtaritë e siguruar dhe as nuk është karakteristike e rrezikut të siguruar.
- b. Furnizimi i energjisë elektrike, nxehtësisë, gazit ose ujit.
- c. Prodhimi, përpunimi, transporti, ruajtja e eksplozivëve për çdo qëllim.
- d. Ndryshimi i ambientit ujqor.
- e. Përgjegjësia për humbjet në lidhje me qëndrimin në ndërtesa, dridhjen (p.sh. për shkak të goditjeve ose punimeve goditëse ose shkarjes së tokës).

V. Kufizimet e sanksioneve dhe klauzola përjashtuese

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi për aq sa ofron mbulim sigurimi nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/ose embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji ose legjislacioni vendor të aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, tregtare ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vende tjera, për sa kohë nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

Përjashtimi i sëmundjeve të transmetueshme

Kjo policë sigurimi nuk zbatohet për asnjë dëmtim, përgjegjësi, kërkesë, humbje, pagesë, kostë ose shpenzim të çdo natyre, aktual ose të pretenduar, që rrjedh nga, drejtpërdrejt ose tërthorazi si rezultat i, i atribuohet, ose në ndonjë mënyrë në lidhje me:

1. Çdo sëmundje të transmetueshme;
2. Çdo sëmundje ose gjendje e padiagnostikuar që dyshohet ose ka të ngjarë të jetë një sëmundje e transmetueshme;
3. Çdo frikë ose kërcënim (qoftë real ose i perceptuar) i ndonjë sëmundje të transmetueshme;
4. Çdo veprim i ndërmarrë për të kontrolluar, parandaluar, shtypur, mitiguar ose në çfarëdo mënyrë që ka të bëjë ose ka lidhje me ndonjë ngjarje aktuale ose të dyshuar ose shpërthim të ndonjë sëmundje të transmetueshme, ose ngjitjen, ose përhapjen e saj.
- 5.

Për qëllimet e këtij përjashtimi, sëmundje e transmetueshme nënkupton çdo sëmundje ngjitëse që lind ose në ndonjë mënyrë ka të bëjë me ndonjë virus ose agjent infektiv ose biologjik ose produktet e tij toksike, që transmetohet ose përhapet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, tek një person nga një person, bimë, kafshë ose antropoid i infektuar, ose përmes ndërmjetësimit të një kafshe të ndërmjetme, bartës ose vektor i mjedisit të pajetë ose transmetohet ose përhapet me instrument ose ndonjë metodë tjetër transmetimi.

Sëmundja e transmetueshme përfshin, por nuk kufizohet me, Sindromën e Fituar të Imunodeficiencës (AIDS) ose Virusin e Imunodeficiencës së Njeriut (HIV), çdo lloj ose tipi/shtami të Sindromës akute të Rëndë Respiratore (SARS) ose Sindromës akute të Rëndë Respiratore Coronavirus 2 (SARS-CoV-2), Sindromes Respiratore të Lindjes së Mesme (MERS), Sëmundjes së Nil Perëndimor, virusit Zika, Lisë, çdo lloj apo tipi/shtam i gripit ose sëmundjes infektive respiratore (përfshirë, por pa u kufizuar me, gripin e shpendëve, virusin Corona ose COVID-19), pneumonisë, legjionelës, hepatitit, fruthit, meningjitit, mononukleozës, kollës së mirë, kolerës, etheve hemorragjike Ebola, murtajës bubonike dhe antraksit.

Nëse siguruesi pretendon se ky përjashtim zbatohet, atëherë barra e provës për të kundërtën do të jetë e të siguruarit.

VI. Marrëveshje të tjera

1. Ndërmarrjet e përbashkëta.

Për kërkesat për dëmsëpërblim të përgjegjësive që rrjedhin nga pjesëmarrja në një ndërmarrje të përbashkët, pavarësisht nga parashikimet e tjera të marrëveshjes (veçanërisht kufijtë e dëmsëpërblimit), do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

- a. Detyrimi i siguresit për dëmsëpërblim kufizohet në përqindjen e pjesës së të siguruarit në grupin e përbashkët, pavarësisht se cilës shoqëri partner i përkasin personat ose pasuria (makina, pajisje ndërtimi, materiale ndërtimi etj.) që është përgjegjës për humbjen.
- b. Përjashtohen nga mbulimi në sigurim
- c. Kërkesat për dëmsëpërblim të përgjegjësive që rrjedhin në lidhje me humbjet e pësuar nga çdo lloj pasurie e futur në ndërmarrjet e përbashkëta nga partnerët individualë ose e blerë nga ndërmarrja e përbashkët, pavarësisht se cili është përgjegjës për humbjen.
- d. Përjashtohen gjithashtu nga mbulimi në sigurim
- e. Kërkesat për dëmsëpërblim që bëhen nga partneri i ndërmarrjes së përbashkët në cilësinë e saj si e tillë kundër çdo partneri ose anasjelltas.

2. Kontrataktuesit kryesorë/drejtimi i projektit

Nuk mbulohet përgjegjësia ligjore e nënkontraktuesve.

Pranuar nga:_____